



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 114, datë 10.12.2009**

**PËR  
MIRATIMIN E LICENCËS PËR USHTRIM VEPRIMTARIE SI BROKER NË  
SIGURIME**

Në bazë dhe për zbatim të pikës 6/dh të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të pikës 1 të nenit 81, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” dhe të, VKM nr. 79, datë 28.01.2008 “Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime dhe të rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës”, me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoritetit i Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Licencimin e shoqërisë “LANDES Broker” sh.a si “Broker në sigurimeve” për klasat e jo-jetës, për një periudhë pa afat.
2. Licencimin e Z. Arben Simaku si “Broker fizik në sigurime“ në emër dhe për llogari të shoqërisë “LANDES Broker” sh.a, për klasat e jo-jetës, me afat 3 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Ngarkohen Departamentet përkatës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR  
Elisabeta GJONI**